

Plagosja në Gjilan: Arrestohen 6 persona



25/12/2023 09:14



Një 33 vjeçar u plagos mbrëmë në fshatin Gadish të Gjilanit. Lidhur me këtë tentim vrasje, Policia e Kosovës përmes raportit 24 orësh ka dhënë detaje të reja.

Policia bënë të ditur se lidhur me këtë rast janë arrestuar 6 të dyshuar, njëri nga ta i mitur.

“Janë arrestuar gjashtë (6) të dyshuar meshkuj kosovar (njëri nga ta i mitur) pasi të njëjtit fillimisht kishin sulmuar fizikisht viktimën mashkull kosovar (roje pylli) e më pas njëri nga të dyshuarit kishte shtënë me armë gjuetie në drejtim të viktimës. Si pasojë viktima është plagosur në këmbë”, njofton policia.

Policia shton se në vendin e ngjarjes, gjatë kontrollit të veturës së personave të dyshuar është gjetur dhe konfiskuar një armë gjuetie.

“Viktima është dërguar në tretman mjekësorë dhe i njëjti sipas raportit mjekësorë është jashtë rrezikut për jetë. Me vendim të prokurorit pesë të dyshuar janë dërguar në mbajtje, ndërsa i dyshuari i mitur është liruar në procedurë të rregullt”, thuhet në raportin e policisë.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupaMedia



Ja cili është kuptimi nëse keni parë ëndërr sikur je shtatzënë



Kjo është kënga që përfaqëson Shqipërinë në



Buci dhe Santiana nuk mund të distancohen, përsëri shumë



Edona – Ganiut: Ti je alkoolik, dil jashtë dhe kërko ndihmë



A NANNY FOR AURORA CHAPTER 1

Artikuj të ngjashëm



December 25, 2023

Thaçi në luftë e kishte “Gjarpri” – Shoku i tij tregon si i mbeti nofka



December 25, 2023

Protesta në Serbi: Petković “kapet” me raportimin e mediave në Kosovë...



December 25, 2023

Rexha: Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve të merren me prioritet



December 25, 2023

Gjendet pa shenja jetë në kulmin e shtëpisë, policia nis hetimet



December 25, 2023

Hidhet nga kati i nëntë i pallatit, ndërron jetë 18-vjeçari nga Durrësi



December 25, 2023

Ambasadori amerikan së bashku me vajzat e Osmanit këndojnë “Jingle Bells”...